


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Korrik 2023

Tiranë, më 07 Gusht 2023: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Korrik 2023, arriti 113,8 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Korrik 2023 është 4,2 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 7,5 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Korrik 2023, krahasuar me Qershor 2023 është -0,1 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Korrik është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +3,20 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,44 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,26 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,23 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,22 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,21 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me +0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,06 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” me -0,84 pikë përqindje.

Për publikim 07/08/2023

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Korrik 2022, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 9,5 %, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 9,0 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 6,0 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 5,0 %, “Veshje dhe këpucë” me 4,3 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,8 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,7 %, “Shërbimi arsimor” me 2,0 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,3 %, “Komunikimi” me 1,2 % dhe “Shëndeti” me 1,1 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 12,4 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 21,6 %, pasuar nga nëngrupet “qumësht, djathë dhe vezë” me 13,8 %, “mish” me 11,2 %, “fruta” me 7,0 %, “peshk” me 6,1 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 3,6 %, “bukë dhe drithra” me 2,9 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Qershor 2023, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u ulën me 0,9 %, pasuar nga çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,6 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Transporti” u rritën me 0,7 %, pasuar nga “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,6 %, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Veshje dhe këpucë” me 0,4 % secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë”, “Shëndeti” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,2 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	07-22	08-22	09-22	10-22	11-22	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23
	Gjithsej	100	109,3	110,1	110,8	111,2	110,9	111,4	112,6	113,9	114,7	114,7	114,3	114,0	113,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	35,6	116,2	118,0	119,3	119,8	119,7	121,4	124,5	128,7	130,8	130,5	129,0	127,4	126,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	106,8	107,4	107,7	107,3	107,4	107,7	108,2	108,6	109,2	109,8	110,3	110,3	110,8
3	Veshje dhe këpucë	3,6	102,3	102,0	104,2	104,7	105,2	105,6	105,5	105,3	105,3	105,4	105,8	106,2	106,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,5	104,0	104,2	104,4	105,0	104,8	104,8	105,1	105,1	105,2	105,2	105,4	105,4	105,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	105,0	105,4	106,3	107,2	107,3	107,7	108,0	108,7	109,3	110,3	110,7	111,0	111,2
6	Shëndeti	4,2	101,3	101,3	101,6	102,0	102,1	102,0	101,9	102,0	102,0	102,2	102,2	102,3	102,5
7	Transporti	6,4	125,3	125,3	123,2	125,0	119,0	115,6	116,4	113,1	112,0	110,7	109,3	109,0	109,8
8	Komunikimi	3,1	103,7	103,9	103,9	103,8	104,4	104,6	104,6	104,6	104,7	104,9	104,9	104,9	104,9
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	101,2	106,7	107,0	104,3	105,0	105,6	106,0	106,3	108,0	108,5	109,9	111,8	110,8
10	Shërbimi arsimor	3,0	100,9	100,9	102,6	102,2	102,5	102,8	102,9	102,9	102,8	102,9	103,0	103,0	103,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,5	107,2	107,6	108,0	108,1	108,7	108,7	109,4	109,5	110,0	110,4	111,4	111,8	112,5
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	101,6	101,8	102,7	103,0	103,1	103,0	103,3	103,6	103,9	104,6	105,0	105,2	105,4

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	07-22/07-21	08-22/08-21	09-22/09-21	10-22/10-21	11-22/11-21	12-22/12-21	01-23/01-22	02-23/02-22	03-23/03-22	04-23/04-22	05-23/05-22	06-23/06-22	07-23/07-22
	Gjithsej	7,5	8,0	8,1	8,3	7,9	7,4	7,2	7,1	5,3	4,6	4,7	4,5	4,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	13,2	14,0	14,0	14,6	14,7	14,2	13,3	13,5	11,0	9,6	10,0	10,3	9,0
2	Pije alkoolike dhe duhan	5,0	6,2	6,5	5,7	5,8	5,5	5,1	5,1	2,8	3,8	3,7	3,7	3,8
3	Veshje dhe këpucë	2,1	1,9	3,0	3,0	3,6	3,8	4,1	4,4	3,7	3,9	4,2	4,4	4,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	3,4	3,2	3,3	3,6	3,1	2,8	3,0	3,1	2,6	2,3	2,2	2,1	1,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	4,2	4,7	5,5	6,5	6,2	6,5	6,4	6,9	6,6	6,7	6,5	6,2	6,0
6	Shëndeti	0,5	0,6	0,9	1,3	1,3	1,1	1,0	1,0	1,1	1,4	1,4	1,2	1,1
7	Transporti	19,7	19,3	17,2	16,9	9,6	6,0	6,5	1,7	-7,5	-10,7	-12,3	-16,2	-12,4
8	Komunikimi	0,7	0,9	0,9	0,7	1,1	1,3	1,3	1,2	1,4	1,2	1,2	1,4	1,2
9	Argëtim dhe kulturë	0,2	5,2	4,7	1,7	1,0	1,3	1,8	3,4	4,7	2,4	6,9	10,3	9,5
10	Shërbimi arsimor	0,7	0,7	1,8	1,8	1,9	2,3	2,3	2,3	2,0	2,1	2,2	2,2	2,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	6,0	6,2	6,4	6,1	6,1	5,2	5,6	5,5	4,6	4,5	5,0	4,8	5,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	1,5	1,9	2,9	3,3	3,6	3,3	3,6	3,2	3,2	3,6	4,0	4,0	3,7

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	07-22	08-22	09-22	10-22	11-22	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23
	Gjithsej	0,2	0,8	0,6	0,4	-0,3	0,4	1,1	1,1	0,7	0,0	-0,3	-0,3	-0,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	0,6	1,5	1,1	0,4	-0,1	1,5	2,6	3,3	1,7	-0,2	-1,2	-1,2	-0,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,4	0,6	0,3	-0,4	0,1	0,2	0,5	0,3	0,6	0,5	0,4	0,0	0,4
3	Veshje dhe këpucë	0,5	-0,2	2,1	0,5	0,5	0,3	-0,1	-0,2	0,0	0,1	0,5	0,4	0,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,7	0,2	0,2	0,6	-0,2	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,4	0,4	0,9	0,8	0,2	0,3	0,3	0,7	0,6	0,9	0,3	0,3	0,2
6	Shëndeti	0,3	0,0	0,3	0,4	0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,0	0,3	0,0	0,0	0,2
7	Transporti	-3,7	0,0	-1,7	1,5	-4,8	-2,8	0,7	-2,8	-1,0	-1,1	-1,2	-0,3	0,7
8	Komunikimi	0,2	0,2	0,0	0,0	0,5	0,2	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	-0,1	5,5	0,3	-2,5	0,7	0,5	0,4	0,3	1,6	0,5	1,2	1,8	-0,9
10	Shërbimi arsimor	0,1	0,0	1,6	-0,4	0,3	0,4	0,0	0,0	-0,1	0,1	0,1	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,5	0,4	0,4	0,1	0,5	0,0	0,6	0,2	0,4	0,4	0,9	0,3	0,6
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,4	0,3	0,9	0,2	0,1	-0,1	0,2	0,3	0,3	0,6	0,4	0,2	0,2

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2021.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbledhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.